

## Frederick Turner: Keni marrë më të keqen nga Amerika

2011-05-15

### Librat e rinj

Poeti amerikan, Frederick Turner, ka vizituar dje për herë të parë Shqipërinë. Ishte i pranishëm në Tiranë për promovimin e librit të tij të ri, "Vendi i pazbuluar: sonatat e një shtegtari", botuar më parë në shqip nga shtëpia botuese "Nacional", me shqipërimin e poetit shqiptar Gjekë Marinaj, profesor i letërsisë bashkëkohore në Universitetin Richlandit. Turner, autor bashkëkohor i poezisë amerikane, në këtë takim, me njerëzit e letrave, ka folur pashmangshmërisht për poezinë, filozofinë e të vërtetën, për epikën shqiptare, për procesin e tij të krijimit. Ky libër, tri javë më pas, do të botohet anglisht. Janë sonata që në një mënyrë apo tjetër i referohen kohës dhe njeriut modern në një vështrim krahasues me të shkuarën e me të ardhmen. Libri fillon me një karakter të vdekur, i cili ringjallet për të vazhduar historinë e tij, por me një pasojë të pashmangshme. Pa kujtesën e tij që humbet në mënyrë graduale. "Postmodernizmi mund të konsiderohet si një rrymë që synon drejt pavdekësisë dhe humbjes së kujtesës, rrjedhimisht të humbjes së identitetit", ka thënë dje Turner në Tiranë. Lindur në Angli në vitin 1943, Frederick Turner (Profesor Themelues pranë Shkollës së Arteve dhe Shkencave Humane në Universitetin e Teksasit në Dallas), është poet, kritik kulturor, dramaturg, filozof i shkencës, specialist i estetikës, eseist dhe përkthyes letrar. Ai u rrit në Afrikën Qendrore nga prindërit e tij, antropologët Victor W. Bush dhe Edith LB Turner, dhe u arsimua në Universitetin e Oksfordit. Turner është fitues i disa prej çmimeve letrare më prestigjioze dhe është propozuar në shkallë ndërkombëtare mbi dyzetë herë për çmimin "Nobel" në letërsi. Ai ka ardhur në Tiranë njëkohësisht edhe si bashkautor i një libri në anglisht me Gjekë Marinajn për Eposin e Veriut. Në prill të këtij viti, libri "Kënduar Majëkrahut: Poezi heroike Iliriane" (Sung Across the Shoulder: Heroic Poetry of Illyria) është botuar anglisht nga shtëpia botuese e Universitetit të Dallasit, në Teksas, "Mundus Artium Press". Si ish-student i poetit, Marinaj tregon se në të janë botuar poezi epike të vjelë nga njerëzit e thjeshtë që i dinë ato përmendësh, duke filluar nga i ati. Libri është një studim i letërsisë së Eposit të Veriut dhe këngëve folklorike të krahinës së Malësisë së Madhe të Shqipërisë. Rezultat i një pune akademike mbi pesëvjeçare, shumica e versioneve të poezive janë të pabotuara më parë në letërsinë shqipe. Kjo në njëfarë mënyre ka qenë kontakti më i drejtpërdrejtë i poetit me botën shqiptare. "Jam i lumtur për atë që kemi bërë, por edhe më shumë i këtu për faktin se këta poetë e këngëtarë të mrekullueshëm të epikës që ne kemi përkthyer mund të marrin vëmendjen që meritojnë. Dyvargëshi tetrametër shqiptar, forma dominuese në poezinë gojore të malësoreve, tingëllon mrekullueshëm në anglisht. E gjithë kuraja, urtia, furia, pasioni dhe humori i këndshëm, mendoj se vijnë në gjuhën tonë me një dinamizëm të veçantë. Momentalisht jam duke punuar në një studim për epikën që shpresoj se do ta rehabilitojë atë formën e vjetër antike për botën letrare bashkëkohore. Poezia epike shqiptare zë një vend krenarie midis literaturës madhështore epike të pjesës tjetër të botës", thotë Turner, i cili u shpreh i kënaqur që mundi të ishte i pranishëm fizikisht mes lexuesve shqiptarë, ndërkohë që krijimtaria e tij ka qenë e pranishme që në vitin 2006 me librin "Në shpellën e Platonit". "Është e vërtetë që libri im i ri është përkthyer më parë në shqip dhe për dy-tri javë do të botohet anglisht. Kjo ka ndodhur pasi Gjekë Marinaj dhe disa kolegë të vendeve të tjera punojnë më shpejt se njerëzit në Amerikë për të bërë publikimin", është shprehur poeti. Ndërkohë i pyetur për fenomenin e librave të shumtë të ardhur nga Amerika, që kryesisht janë bestseller, por jo detyrimisht letërsi e mirëfilltë, Turner ka theksuar: "Më vjen keq t'u them se Amerika merr çdo të mirë nga çdo vend i botës dhe e përpunon për të mirën e saj, ndërsa çdo vend tjetër i botës, merr më të keqen e Amerikës. Ky është realiteti. Ju kërkohet ndjesë që kaq shumë gjëra të këqija kanë ardhur nga Amerika". I dominuar disa herë për çmimin "Nobel", poeti nuk e fsheh kënaqësinë që do t'i jepte ky çmim, ndërsa e sheh atë edhe si një mundësi për t'iu përkushtuar tërësisht krijimtarisë. "Do t'i përdorja paratë e çmimit "Nobel", duke vazhduar me fantazinë. Ndoshta do t'i përdorja si mundësi lejimi për t'u larguar pjesërisht nga detyrat e mia

- Frederick Turner: Keni marrë më të keqen nga Amerika
- Librat e rinj

\* (gjithë rubrikat)

Politike  
Aktualitet  
Sociale  
Ekonomi

(\*gjithë rubrikat)

- Dy orë poezi shqipe në SHBA  
2011-11-19
- Fenomeni "Gjekë Marinaj"  
2011-11-11 (Eva Dore)
- Frederick Turner: Keni marrë më të keqen nga Amerika  
2011-05-15
- Arrestohet autori i plagosjes së kandidatit të LDK-së në Lezhë  
2011-04-04
- Librat e rinj  
2010-08-01
- 350 studentët që përfunduan procesin  
2010-05-15
- Prefekti i Shkodrës: Nuk kemi ende vlerësim paraprak të dëmit  
2010-01-21 (Ardi Hoti)
- Lirizmi poetik i Gjekë Marinajt  
2009-06-30
- Poeti sjell "Lutje në ditën e tetë të javës"  
2008-12-19
- Shkolla e policisë, të gjithë emrat dhe kodet e aplikantëve  
2008-07-01
- Një poet amerikan nderohet me emrin e Pjetër Arbnorit  
2007-11-22
- "Si e futa Kadarenë në programet mësimore të kolegjit të Dallasit"  
2006-11-12 (Dashnor Kaloçi)



profesionale, si dhe për të financuar publikime shtypi dhe interneti nga kompanitë ku talentet e vërteta poetike, të reja dhe të vjetra, do të fitonin më shumë vëmendje se sa kanë marrë nga industria e botimeve konvencionale”, ka thënë Turner. Ndërkohë që vazhdon të jetë i angazhuar si pedagog, e ndërsa e ka shpallur se Shekspiri është obsesioni i tij, Frederick Turner e ka të qartë se çfarë do të bëjë në të ardhmen: “Unë mendoj se nuk mund të shkëputem kurrë nga të shkruarit e poezisë derisa të vdes. Edhe tani, puna ime akademike, profesionale dhe pedagogjike shpeshherë më mbajnë larg zemrës së poetikës që krijoj. Kështu që çmimi, faktikisht, mund të më lironte nga këto obligime që të shkruaja”.

## OPINION

### INTEGRIMI, KUR QEVERIA SILLET SI OPOZITË

2012-03-03 (SKËNDER MINXHOZI)

A ka një mënyrë për të zgjidhur ngërçin disaveçar që po mban të bllokuar procesin e integrimit evropian të Shqipërisë? Ja një pyetje të cilën po e bëjnë gjithnjë e më shpesh në Bruksel. Por ...

- **RINIA E TRANZICIONIT SI MINË ME SAHAT**  
2012-03-03 (MENTOR KIKIA)
- **POSHTË SUNDUESI – RROFTË VASALI !**  
2012-03-03 (KIM MEHMETI)
- **KUR NËPËRKËMBET SHTETI**  
2012-03-03 (ENDRI XHAFO)

## POLITIKE

- **Spahiu mban tubimin që iu ndalua nga policia** 2012-03-03
- **Rama: Kur kërkova lirinë e të burgosurve, Saliu ishte kundër** 2012-03-03 (Skerdilajd Zaimi)
- **Kryebashkiaku i Kavajës paralajmëron protesta** 2012-03-03
- **Zela apo Tahiri? Sot PS-ja zgjedh kryetarin e Tiranës** 2012-03-03
- **Wollfarth: Politika ta ketë parësor integrimin në BE** 2012-03-03

## AKTUALITET

- **Gjykata: Masakra e Kozarës, vëllavrasje** 2012-03-03 (Mimoza Haxhialiu)
- **Familja Marra: Dënimi i Luanit, vrasja e pestë në radhët tona** 2012-03-03
- **Nafta virgin, dënohen dy të parët** 2012-03-03 (Sokol Çobo)
- **Çanta me drogë, në vend të pacientëve** 2012-03-03 (Ardi Hoti)
- **Arrestohet për një grabitje me armë në mes të Fierit, dyshohet për raste të tjera** 2012-03-03

## SOCIALE

- **Plani për investimin e 357 milionë lekëve** 2012-03-03 (Lorina Mixha)
- **Importi i barnave me çmimet e Italisë, Greqisë, Maqedonisë** 2012-03-03 (Lorina Mixha)
- **Punonjësit e “Plus Communication” dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë**  
2012-03-03 (Lorina Mixha)
- **ISSH, shërbime për emigrantët shqiptarë në Itali** 2012-03-03
- **800 milje udhëtim për t'u shpëtuar trupave naziste** 2012-03-03 (Xhovani Shyti)

## EKONOMI

- **Portokajtë nga Italia përmbysin tregun te ne** 2012-03-03 (Gjergj Erebara)
- **Konkurrenca nga jashtë vret prodhimin vendas** 2012-03-03
- **Lvovsky: Mos shpresoni vetëm te qeveria** 2012-03-03
- **Pronarët, tjetër aplikim tek AKKP për kompensimin** 2012-03-03
- **Avokati i Popullit, pesimist për procesin** 2012-03-03

## RAJON

- **Beogradi mban sërish peng veriun e Kosovës** 2012-03-03
- **Sekretarja e Shtetit Clinton përgëzon Beogradin dhe Prishtinën** 2012-03-03





















## BOTE

- **Bruksel, nënshkruhet pakti për disiplinën e re buxhetore** 2012-03-03
- **Përse qeveritë e vendeve në krizë i kanë shtuar masat shtrënguese** 2012-03-03

## NDRYSHE

- **30 mënyra për t'u bërë më të zgjuar** 2012-03-03

Lart: 19°C Ulet: 5°C		3°C
Nesër		Lart: 17°C Ulet: 6°C
Pasnesër		Lart: 17°C Ulet: 6°C

- **Diktatorët e Lindjes së Mesme dhe zonjat e tyre të para** *2012-03-03*
- **Francezët: Mite të vërtetë dhe të rreme për ta** *2012-03-03*

## KULTURE

- **Shqipëria: A VIRTUAL–LAND** *2012-03-03 (Arian Leka)*
- **Erioni i propozon Kludjas për t'u lidhur** *2012-03-03*

## SPORT

- **“Letra e De Biazit, vendimtare për të karikuar futbollistët”** *2012-03-03 (Endrit Shkurti)*
- **Kastrioti hedh dorashkën, Tirana vuan nga dëmtimet** *2012-03-03 (Altin Manallari)*
- **Shqipëria e Xhani de Biazit, në sytë e mediave italiane** *2012-03-03*
- **Xherdan Shaqiri: Humbje e padrejtë me Argjentinën** *2012-03-03*
- **Çani, momenti magjik i sulmuesit kuqezi** *2012-03-03*

### Rubrikat

Politikë  
Aktualitet  
Sociale  
Ekonomi  
Rajon  
Kulturë  
Bote  
Sport

### Extra

Opinion  
Ndryshe  
Reportazh  
Horoskopi  
Forum

### Top Media

Top News  
Top Channel  
Digitalb  
Top Albania Radio  
Top Gold  
Super Sport

### Kontakt

Kryeredaksia  
Marketing  
Cel: 069 20 35 300  
Cel: 069 20 50 420  
Cel: 069 20 50 458